Vdekje fashizmit — Liri Popullit

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

DEL DY HERE NE JAVE: T'ENJTEN DHE TE DIELLEN

Redakcija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din.
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorashkrimet nuk kthehen

Drejtori pergjegjes SEDAT DIDA

Vjeti IV Nr. 170 | PRISHTINE, e dielle 26 Dhetuer 1948 | Çmimi 2 dinare

Konferenca e Katert Krahinore e Partis

Me njizet te ketij mueji ka fillue nga puna e saj Konferenca e IV e PKS per Kosove e Metohi. Salla e shtepis se kultures qe asht ndertue tash ne Prishtine, ku po mbahet konferenca, asht dekurue ne menyre soleme me flamuj, me fotografi t'antarve te Komitetit Qendruer te PKJ-es dhe te Byros Politike, me fotografit e Marksit, Engelsit, Lenjinit, Stalinit dhe me bustin e Madh te Marshalit Tito.

Konferenca filloi nga puna e saje n'ora 9 para-dite, ne pranin e delegatve, perfaqsuesit te KQ te PKS shokut Dushan Petroviq dhe perfaqsuesit te Komitetit provincjal te PKS per Vojvodin, shokut Djura Jovanoviq, perfaqsuesve te pushtetit popullluer, t'armotes Jugosllave dhe dhe t'organizatave masovike.

Konferencen e hapi sekretari politik i komitetit Krahinuer te PKJ, shoku Gjoko Pajkoviq. Ky antar i Komitetit Qendruer te PKJ, shoku Djoko Pajkoviq. Ky mbassi i pershendeti delegatet propozoi zgjedhjen e kryesis se punes. Ne kryesin e punes hyni Predrag Ajtiqi, Dushan Mugoshi, Pavle Joviqeviqi, Fadil Hoxha ,Cica Paternogiq, Xhavid Nimani, Krsta Filipoviq, Gjoko Pajkoviq, Mita Milkoviq, Spasoja Gjokoviq, Ali Shukrija, Xhevdet Hamza, Ismet Shaqiri, Nexhmedin Kuçi dhe Mon. Moni. Derisa antaret e kryesis se punes zune vendet e veta te pranishmit e kenduen internavjonalen.

N'emen te kryesis se punes, shoku Pavle Joviqeviq propozoi rendin e dites si vijon:

1) Referati mbi punen politike t'organizates te Partis ne Kosove e Metohi - Referent shoku Gjoko Pajkoviq;

2) Referati mbi punen organizative t'organizates se Partis - Referent shoku Predrag Ajtiq;

3) Referati mbi punen kulturo-Politike t'organizatave te Partis - Referent shoku Xhavid Nimani;

4) Zgjedhja e Komitetit Krahineur te PKS per Kosove e Metohi dhe e komisjonit Krahinuer te revizjonit.

Mbas pranimit te rendit te dites u-fillue zgjedhja e antarve te komisjonit Verifikues dhe kandidues. Mandej shoku Pavle Joviqeviq ia dha fjalen delegatit te KQ te PKS shokut Dushan Petroviq-Shane, i cili n'emen te KQ te PKS e pershendeti konferencen dhe nder te tjera tha:

Fjalimi i shokut Dushan Petroviq

Shoke e Shoqe,

«Ne konferencen t'uej te IV te Partis, do t'a analizonje punen e organizates s'uej te Partis nepermjet te referateve dhe te diskusjoneve, do t'a çmoni punen t'uej te deritashme dhe ne baze te kesaj do t'i caktoni detyret e reja, mandej ne ket konference do t'a zgjedhni udheheqsine t'uej Krahinore. -Prandaj konferenca e juej e sotshme asht me shum randesi.

Krejte organizata e Partis ne Serbi asht tue u-pergadite per Kongres i cili do te mbahet ne fillim te vjetit te ri. Kongresi i II-te ka randesi te madhe per krejte organizaten e Partis ne Serbi. Randesija e tij qendron ne faktin se mbahet mbas ma se tri vjetve mbas mbajtjes se kongresit te pare. Gjate kohes se kalueme Partija e jone asht masovizue, nepermjet akcjoneve te perditshme asht armatose me eksperienca te reja dhe ka korre suksese te randesishme, tue i udheheqe shtresat e popullit ne lufte per transformomin socjalist te Vendit t'one.

Kongresi i II-te duhet me i shqyrtue t. gjitha sukseset e korruna dhe me i shtrue detyret e reja. Kongresi i II-te asht i randesishem nga fakti se mbahet disa muej mbas Kongresit te V-te te PKJ. Ky do t'i konkretizoej edhe ma afersisht vendimet e Kognresit te V-te».

Mbassi vueni ne dukje rezultate', e mdhaja te mbrrijtuna qysn prej çlirimit e deri me sot tha: «Vendi i jone po merr nji pamje te re, nga nji vend i mbrapambetun siç ka qene kur kane sundue ne te kapitalistat po b het vend i perparuem dhe industrijal ne saje te perpjekjeve te te gjithe njerzve punues.

Nga rrjedhin te gjitha keto? Keto rrjedhin nga se njerzit punues i kane permbyse shfrytzuesit nga pushteti pse nuk punojne ma per te tjeret, per kapitalista-per parasite. Per shkak se jane ba zot te çdo gjoje, jane ba te vetdijshem se gjitheshka ndertojne, e ndertojne per vehten e tyne pa fmijte e tyne, per nji t'ardheme ma te mire. Per shkak se jane te vetdijshem se po e perforcojne rendin e ri shoqnuer rendin socjalist, ku nuk ka me pase papunsi, uri dhe mjerim.

Kjo rrjedhe nga fakti se na udheheqe drejte kesaj rruge me plot siguri PKJ-a Heroike e provueme ne zjarrin e luftes.

Kjo rrjedhe nga fakti se, ne krye te Partis s'one ndodhet biri i madh i popujve dhe i Partis s'one-Shoku Tito.

Para Partis s'one edhe kendej e tutje qendron detyra e mobilizimit te turmave te gjana popullore per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one. E kejo do me thane t'a perhapim edhe ma teper enthuzjazmin e punes, t'i zgjanojme garat socjaliste ne popull, t'a zhvillojme punen politike me nji mase edhe ma te gjane ne shtresat punuese, keshtu qe çdo njeri te bahet i vetedijshem per rolin e vet ne kryemjen e detyrve. T'a zhvillojme edhe ma teper vigjilancen politike te turmave popullore ne lufte kundra damtuesve te ndryeshem. T'a zgjojme edhe ma teper frymen e kursimit dhe te rujtjes se pasunis se popullit. Te kujdesohemi edhe ma teper per nevojat e perditshme te njerzve: banesen, furnizimin dhe pergjithesisht per kushtet e jeteses si dhe per nji vara detyresh tejra.

Per me mujte Partija me i krye me sukses te gjitha detyret qe qendrojne perpara saje, pa tjeter ajo duhet te forcohet dhe te perforcohet. E kjo do me thane: me pranue me guxim njerez te rij, puntore, te cilet shquhen me punen e tyne ne prodhim, katundaret e varfen dhe punues ne pergjithesi. A kemi ne njerez t'etill, te cilet meritojne me e mbajte emnin e nderit t'antarit te Partis s'one, e te cilet ende nuk ndodhen ne rradhet e saje. Po kemi. Ne perpjekjet e mdhaja qe i bajne popujt t'one ne lufte per ndertimin e socjalizmit ke ne, shquhen me mija puntor, katundare, te cilet perpiqen me vetmohim ne punen e perditshme, per zbatimin e vijes se Partis. Njerzit e ketill duhet me i pranue me guxim ne Partin t'one.

Me e perforcue e forcue Partin t'one, d.m.th. me e ngrite vazhdimisht nivelin ideo-politik dhe te pergjitheshem kultural t'antarve te Partis. Me i armatose sistematikisht antaret e Partis s'one me teorin e Marksizmit — Lenjinizmit. Ne lidhje me ket para çdo antarit te Partis s'one shtrohet per detyre me e studjue materjalin e Kongresit te V-te, i cili asht thesar per edukimin marksist te çdo individi.

Ma ne fund, me e perforcue Partin t'one domethane me punue vazhdimisht per ngritjen e tiparit komunist ke antaret e Partis. Me i zhvillue ke keta vetit, te cilat e zbukurojne nji komunist: saktesin dhe pergjegjesin ndaj punes, autokritiken ndaj dobesive te veta' qendrueshmenin bolshevike per perballimin e veshtirsinave' ndershmenin etj.

Ne fund me e forcue Partin d.m.th. me e perforcue vazhdimisht unitetin e rradhve te saja. Partija e jone ka muejt me bashkue turma kolosale te popullit ne lufte kundra fashizmit para lufte, me i korre fitoret madheshtore gjate luftes Nacjonal—çlirimtare dhe tash gjate ndertimit te socjalizmit, ne rendin e pare per shkak se ka qene kompakte, per shkak se uniteti i saje ka qene i forte dhe i pa thyshem.

Bashkimi i Partis s'one nuk ka muejte me u-trondite as me sulmet e fundit, te cilat, na bahen nga ana e disa PK, antare te byros informative, sulmet qe jane fillue me rezolucjonin e

(vazhdon ne faqen e dyte)

Generalissimus Josif Visarjonoviq Stalin

Gjashtedhetenande - vjetori i Stalinit te Madh

Me 21 dhetuer u-mbushem 69 vjete te jetes se Josif Visarionoviq Stalinit.

Popujt e Bashkimit Sovjetik, popujt te cilet tashma jane çlirue nga vargojt imperjalist, popujt te cilet luftojne per çlirimin e vet, klasa puntore dhe te gjithe njerzit perparimtare te mbare botes, me rastin e njizet-e nji dhetorit — dite - linjdes se Stalinit te Madh, do t'i kujtojne veprat e mdha historike te Stalinit, rrugen fitimtare te Partis Bolshevike, te Bashkimit Sovjetik dhe t'Armotes se tij, perpjekjet heroike vetmohuese te Bashkimit Sovjetik, te gjitha ato qe jane te lidhuna pazgjidhmenisht me emnin e Stalinit. Fuqit perparimtare te mbare botes do t'i kujtojne veprat e Stalinit, nxanesit besnik dhe bashkepuntorit ma te ngushte te Leninit per krijimin e Partis Bolshevike partis se tipit te ri, n'udheheqejen e Revolucjonit te madh socjalist te Tetorit, per krijimin e shtetit Sovjetik, per krijimin e Armates Sovjetike. Me njizetenji dhetuer u-mbushen gjashtedheteenande vjete te jetes se Stalinit, i cili si bashkepuntori ma i ngushte i Leninit e ka udheheqe drejte per se drejti kryengritjen ne Tetorin e vjetit 1917, i cili ne kohen e luftes civile dhe t'intervencjonit te huej, i ka udheheqe triumfalisht te gjitha luftimet.

Bashke me popujt e BRSS dhe fuqit demokratike te botes edhe popujt e RFPJ me klasen puntore ne krye e nen udheheqjen e Partis se vet Komuniste te Jugosllavis, do t'a kremtojne diten e madhe te lindjes se Stalinit, siç e kane kremtue edhe para luftes ne luftimet kundra regjimeve antipopullore si dhe gjate luftes katervjeçore Nacjonal-çlirimtare, do t'a kremtojne ne jehonen e luftes se vet vetmohuese per realizimin e Planit pesvjeçar dhe te ndertimit te socjalizmit ne vendin e vet si dhe te luftes per paqe kundra nxitesave imperjalista te luftes.

Paraqitja e Stalinit ne historin e levizjes puntore te Rusis, dhe ne Historin e Bashkimit Sovjetik si dhe te levizjes nderkombtare puntore dhe ne historin e njerzimit, asht e atille qe veshtire mund te ndriçohet me nji tregim. Me fole per Stalinin, domethane me fole mbi epoken historike ne zhvillimin e njerzimit, mbi epoken e kalimit te njerzimit nga rendi kapitalist shoqnuer ne rendin e ri socjalist. Me fole per Stalinin domethane me fole mbi partin e tipit te ri — partin bolshevike, me anen e se ciles vetem klasa puntore dhe populli punues munden me luftue me sukses dhe me fitue. Me fole per Stalinin domethane me fole mbi rrugen madheshtore plot vetmohime ne ndertimin e socjalizmit, per rrugen ne te cilen popujt e Bashkimit Sovjetik nen udheheqjen e Partis Bolshevike, me Stalinin ne krye, te paret ne historin e njerzimit, e kane çela me guxim rrugen dhe i kane perballue te gjitha pengesat drejt objektivit — ndertimit te shoqnis se re pa klase. Kjo asht rruga e petoletkave histo-

(vazhdon ne faqen e dyte)

Referatin politik te punes s'organizatave te Partis se Krahines s'one

e paraqiti sekretari politik i Komitetit Krahinuer te PKS per Kosmet e antar i KQ te PKJ- shoku Gjoko Pajkoviq

(vijon nga faqja e pare)

kominformit, e te cilat vazhdojna edhe sot.

Me lejoni pra qe t'i them disa fajle ne lidhje me keto sulme.

Na shoke e kemi dijte se na ket periudhen e mbasluftes, ne perpjekjet qe i bajme per ndertimin e socializmit, do te hasim ne veshtersina te mdhaja dhe na veshtirsina te mdhaja dhe ne rezistence nga ana e anmikut te klases. Nga ana e mbeturinave t'elementave te thyem kapitalista mbrenda ne vend dhe gangsterave imperialista perjashta. Na ketu nuk kemi pase kurfar iluzjonesh. Kundra çdo grushtit te tyne jemi pergjegje me njiqind grushta t'one, ket pune e bajme edhe sot. Natyrisht na nuk kemi shpresue se do te na duhet me i hedhun noshte akuzat e padrejta te disa Partive Komuniste.

Na akuzojne, ase ma mire me thane na shpifen, se zhvillojme nji politike anti-sovjetike, se e kemi braktise frontin socjalist, se jemi ba nacjonalisid, se Partija e jone asht kulake, se asht shkri ne frontin popullluer etj. etj.

Natyrisht, te gjitha keto jane vetem çpifje ma te thjeshta dhe une nuk mendoj me u-ndal dhe me i shpjegue te gjitha keto, sepse rreth ketyne asht fole dhe shkrue mjaft, ju te gjithe i dini keto fare mire, mbi ket pune ka me u-fole ma gjane ne referatet e jueja.

Por, shka po shofim na sot? Nga shpallija e rezulucionit te Byros Informative, kane kalue tashma disa muej, e kritikuesat t'one na sulmojne vazhdimisht. Por se tue qene se dita dites po shkojme perpara, keto sulme bahen ma paprincipale, shpifse, nuk zgjidhen mjetet, nuk kursehen per trillime te çdo lloji. E Partija e jone, popujt t'one gjithnji ma kompakt, te bashkuem ma forte rreth KQ dhe shokut Tito. Pse qendron puna keshtu, mbassi ndryshe ase nuk mund te jete, sepse ai qe e pohon dhe e mprone te pavertetan, e ket e bajne kritikuesit t'one, ne qofte se edhe e quejne vehten komunista, nuk don me e pa gabushmenin e pohimeve te veta ,por me kambe naulje i vazhdojne keto, at-here pa tjeter do t'i duhet me i perdore te pavertetat, shpifjet. Ai pa tjeter, sikurse edhe kritikuem t'one do t'i perdorin metodat e propagandes imperialiste.

N'anen tjeter, ai qe e mpron çashtjen e drejte, mundet vetem me e perforcue bindjen e vet.

Partija e jone, popujte t'one e kane kuptue drejte se rezulucjoni i Byros Informative dhe te gjitha sulmet qe kane rrjedh mbas tij jane sulme kundra unitetit te Partis s'one, popujve t'one, udheheqesis kundra shokut Tito. Bash per shkak se i kane kuptue te gjitha keto ashtu si duhet, i kane forcue radhet e veta dhe qendrojne te pathyeshem rreth Komitetit te vet Qendruer me shokun Tito ne krye.

T'a perforcojme dhe t'a ruejme kompaktesin e Partis.

Shoke, organizata e jone e Partis ne Kosove e Metohi ka mbrrijte deri sot rezultate te dukshme.

Veçanerisht asht mbrrijte rezultat i madh ne perforcimin e bashkimit te shtresave te gjana popullore: shqiptareve, serbve dhe malazezve. Kjo asht veper e madhe qe asht krye nen udheheqjen t'uej direkte. Forconie edhe ma ket bashkim, si garancin ma te madhe te suksesevet dhe te fitorve te reja na ndertimin e socializmit ne Vendin t'one. Bahuni te pameshire kundra atyne qe tentojne me e shkatrrue ket bashkim.

E dyta, asht mbrrijte gjithashtu sukses i madh, nen udheheqjen t'uej edhe perse i perket ngritjes politike te shtresve te gjana punuese, per transformimin kultural te Krahines s'uej.

Asht e dijtun se Krahina e Kosoves dhe Metohis dhe shumica dermuese e popullit, turmat shqiptare, jane marre neper kambe gjitheanshem dhe ne pikpamje kombetare nga ana e borgjezis serbo-madhe ne Jugosllavin e vjeter. Natyrisht kjo ka ndikue ne nji mase te plote ne zhvillimin e pergjithshem ekonomik, politik dhe kultural te turmove te popullit ne Kosove dhe Metohi.

C'prej çlirimit e deri sod jane mbrrijte rezultate te randesishme: jane hape me qinda shkolla te reja, me mija jane mesue shkrim e kendim, botohet shtypi ne gjuhen antare. Nepermjet te kurseve, ligjeratave, seminareve po ngrihet vazhdimisht niveli politik dhe kultural i shtresave te gjana te popullsis.

Shoke, nji nga detyret t'ueja ma te radnesishme, ne mos ma e randesishmja, asht qe edhe kendej e tutje te punoni ngultazi me anen e formave te ndryshme per ngritjen politike dhe kulturale te turmove te popullit. Shpallni lufte te pergjitheshme mbrapambetjes kulturale, ndiqni-e gjithkund dhe çdo vend!

Le te rrnoje Konferenca e juej krahinore e Partis!

Le te rrnoje KQ i PK.

Le te rrnoje udheheqsi dhe mesuesi i popujve t'one - shoku Tito!»

Fjalimi i shokut Dushan Petroviq u nderpre shpesh here me duertrokitje frenetike dhe brohoritje per Marshalin Tito dhe KQ te PKJ. Ne fund te fjalimit delegatet e pershendeten tue çue ne kambe dhe me duertrokitje enthuziastike tue brohorite «KQ — Tito», «Heroj Tito», «Tito — Partija»!

Mbandej e muerre fjalen shoku Gjura Jovanoviq, perfaqsues i Komitetit provincial te PKS per Vojvodinen, i cili e pershendeti Konferencen t'one te katerte krahinore dhe i uroi sukse te plote. Ky vuni ne dukje sukseset e ndryshme te mbrrijtuna ne Provincen Autonome te Vojvodines. Tue fole edhe mbi suksesct e medhaja te korruna ne Krahinen t'one, ne mes tjerash tha:

«Na kemi ndigjue dhe i ndjekim me vemendje suksesetct t'ueja: e dijme se edhe kolektivet t'ueja punues i kane plotesue detyret e prodhimit vjetuer para afatit te caktuem, «Trepça», «Golesh», etj. gjitheashtu dijme per brigadat t'ueja punuese te dekorueme dhe te lavdueme etj. dhe ma ne fund dijme se ç'fare politike zhvillohej ndaj jush e veçanerisht ndaj shqiptarve ne Jugosllavin e vjeter dhe e dijme se ç'fare zhvillohet sod. Do t'i ndjeki me vemendje referatet dhe diskusionet e Konferences s'uej. Po ju deklaroj se me ardhjen prane jush po ndiej per detyrim edhe ma teper qe kur te kthehem ne vendin t'im te perpiqem edhe ma per kryemjen e te gjitha detyreve qe na i shtron Partija e jone dhe shoku Tito».

Referati i shokut Gjoko Pajkoviq

Fille mandej filloj paraqitja e referatit politik nga sekretari i Komitetit Krahinuer te PK te Serbis per Kosmet, shoku Gjoko Pajkoviq:

Shoke e shoqe delegate,

Koha prej mbajtjes se Konferences se III-te krahinore te Partis e kendej, siç na ka tregue Kongresi i Peste i PKJ, asht periudha e fitoreve shum te mdhaja historike, te cilat i kane mbrrijte ne pune njerzit punues te Vendit t'one, te mbledhun rreth Partis s'one, t'udhehequn prej KQ te PKJ me shokun Tito ne krye. Ne saje t'udheheqjes se drejte te Partis s'one, kemi korre sukses n'organizimin e konsolidimin e shtetit te ri populluer, ne fushen e rindertimit ekonomik e te ndertimit te tij socjalist. Me keto fitore historike te Partis s'one, perfshihen suksesct e fitores edhe t'organizates s'one, e cila ne ket lufte i ka krye me mjaft sukses te gjitha detyrat e parashtrueme ne ket periudhe prej Partis e shokut Tito.

Qellimi asht qe ne ket konference, tue çmue ket pune, t'i konstatojme te gjitha suksesct e mos-suksesct, gabimet e leshimet keshtu qe te jemi edhe ma te gatshem per punen e matejshme ne kryemjen e ndertimit socjalist.

Me caktimin e parashtrimin e detyrve t'ardheshme para organizates se Partis, gja qe asht detyre e kesaj Konference, detyra e saje themelore asht qe te konkretizoje e perpunoje detyret, te cilat ne vendimet e Kongresit te V-te te PKJ jane parashtrue para Partis s'one qe ne vijen e dhanun ne raporte, referatet, rezolutet, programin e Statutin e PKJ, t'a caktoje rrugen e realizimit te tyne. Kongresi i Peste i PKJ, neper referatet e vendimet ne perpunimin marksist te te gjithe problemeve te ndertimit socjalist te shtetit t'one i ka dhane Partis s'one armen e fuqishme dhe triumfuese te luftes per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one. Mbare Partis s'one, e pra edhe organizates s'one te Partis, i mbetet qe ket arme te fuqishme t'a njofi mire dhe t'a perdori drejte ne luften e matejshme per ndertimin e shoqnis socjaliste ne Jugosllavin e re.

Keshtu Konferenca do t'i ndihmoje pregaditjet per Kongresin e II-te te PK te Serbis. Me anen e punes se tille kjo Konference do te mundet me e shprehe afe bashkimin e fuqishem te organizatem n'organizaten t'one, afe gatshmeni te pathyeshme t'antareve t'organizates s'one per kryemjen e detyreve te ndertimit socjalist si dhe dashnin e besnikin e tyne te pa-kufi ndaj Partis s'one, Komitetit te Saje Qendror dhe shokut Tito.

Me punen e ketille Konferenca do te jepe nji pergjigje te kjarte organizates s'one kundra akuzave te pa turpshme te Byros Informative.

Mbassi theksoi randesin qe kane sherbye detyret e parashtrueme ne Konferencen e III-te Krahinore te Partis dhe ne Kongresin e I-re te PK te Serbis te cilat ma vone u-zavendesuen me detyret e Planit pesvjeçar, prej Kongresit te Peste te PKJ e deri tash, puna e organizates s'one asht bazue ne vendimet historike te Kongresit te Peste te PKJ, ai tha:

»Detyret themelore politike te cilat i parashtroi Konferenca e III-te Krahinore e Partis dhe Kongresi i I-re i PK te Serbis, para organizates s'one te Partis, ne periudhen fille mbas luftes, kane qene:

1. — Konsolidimi dhe zhvillimi i matejshem i keshillave popullore si organe te pushtetit te popullit punues.

2. — Zgjanimi i radheve te frontit populluer dhe aktivizimi i turmove nepermjet Frontit. Me i paralizue e izolue elementat dhe grupet reakcjonare. Me luftue perforcimin e bashkimit politik ne Frontin populluer per me e realizue vllaznimin e bashkimin e popujve. Ne kete fryme me zhvillue lufte te vendasun kundra te gjitha tendencave shoveniste e hegemoniste te cilat e pengojne realizimin e vllaznimit e te bishkimit.

3. — Me e organizue punen per rindertimin e ekonomis se shkatrrueme ne lufte.

Ne realizimin e ketyne detyreve, para organizates s'one te Partis kane qendrue veshtiresi shum te mdhaja.

Ndersaq, shoku Gjoko paraqiti gjendjen e katundareve te mesem dhe te vorfen, e ne rend te pare te shqiptareve, te cilet kane qene jashte influences s'one e n'anen e reakcjonit shqiptar, d. m. th., t'agallarve, beglerve e t'elementave tjere kapitalist; ai i paragiti te drejtat e fitueme te shqiptareve ne saje te luftes Nacjonal-çlirimtare, ku per katundaret randesi te veçante ka pase edhe zgjidhja e çashtjes agrare e cila mbas çlirimit u-zgjidh ne menyre te drejte tue u-zhduken marredhanjet feudale ne mes te çifçive dhe agallareve e beglereve.

(vijon ne faqen e trete)

Gjashtedhetenande - vjetori i Stalinit te Madh

(vijon nga faqja e pare)

rike te ndertimit socjalist te Bashkimit Sovjetik, me anen e te cilave popujt Sovjetik e kane likuidue mbrapambetjen, jane ba vendi ma i fuqishem ne bote kane ndertue socjalizmin e keshtu e shpetuen njerzimin nga foshizmi barbar, grushtit sulmues te klikave ma reakcjonare imperjaliste.

Me fole per Stalinin dometha ne me fole mbi luften e madhe patriotike te Bashkimit Sovjetik, mbi Armaten heroike Sovjetike, mbi veprat heroike te popujve Sovjetik per shpetimin e BRSS, vendit te pare te socializmit, per mprojtjen e liris dhe te pamvaresis se popujve te vegjel, per shpetimin e njerzimit. Me fole per Stalinin domethane me fole per strategun genjal i cili ka dijte me i bashkue te gjitha fuqit antifashiste dhe me e krye triumfalisht luften çlirimtare kundra pushtuesve fashista gjermano-japoneze dhe satelitve te tyne. Me fole per Stalinin domethane me fole per luften per paqe, per paqen ne bote e kundra nxitesave te luftes dhe robnuesve imperjalista, per demokraci dhe perparimin e vertete te njerzimit.

Me lufte kundra «ekonomistave» e mandej ne lufte kundra menshevikve, Lenini e ka pase Stalinin mbeshtetje te forte, i cili qysh ne vjetin 1904 ishte ne balle te bolshevikve te Zakavkazis dhe shquhej ne luften ideologjike kundra menshevikve e per mprojtjen e bazave ideologjike, organizative dhe taktike te Partis marksiste, e veçanerisht te programit te Partis per kah çashtja kombetare. Na tane ket periudhe deri ne revolucjon Lenini e ka pase Stalinin bashkeluftar besnik ne lufte per partin marksiste te tipit te ri, te partis me te vertete revolucjonare, — te ndryshme nga partit e vjetra, reformiste t'internacjonales se dyte, — partis se vetme qe asht e afte, nen kushtet e imperjalizmit, me e çue klasen puntore deri ne fitore. Kjo lufte per partin e tipit te ri ne bazat besnike revolucjonare dhe ideologjike u-zhvillue nen kushtet e veshtira te carizmit ne Rusi deri ne fitoren e Revolucjonit te madh socjalist te Tetorit ne vejtin 1917, me te cilin fillon, epoka e re ne historin e njerzimit.

Lenini i vueni themelet e shtetit te ri sovjetik, rendit te tij dhe vuni themelet e zhvillimit te tij drejte socjalizmit. Me vdekjen e Leninit, punen e matejshme per zhvillimin e shtetit sovjetik, per ndertimin e socjalizmit, e muer mbi vedi Stalini, i cili nen kushtet e reja i zhvilloi ne menyre genjale ne baze te doktrines se Leninit te gjitha çashtjet e ndertimit te socjalizmit dhe keshtu e pasunoi thesarin e marksizem-leninizmit. Deri atehere ne marksizem shtroheshin bazat per shoqnin e re te pa-klasa, e Stalini, ne zjarin e veshtiresinave ma te mdhaja te ndertimit te socjalizmit, ne baze te doktrines se Leninit, i zbuloi ligjet e reja te ndertimit te socjalizmit, me te cilen gja ua bani te mundun popujve Sovjetik fitoren per ndertimin e shoqnis se re socjaliste dhe i pari ne historin e njerzimit i zbuloi rruget e panjoftuna deri atehere drejte objektivit te madh.

Ne periudhen mbas çlirimit shembujt e popujve Sovjetik ne rindertimin e vendit te vet, perspektivat e ndertimit te socjalizmit i kane ushqye klasen t'one puntore dhe turmat punuese me fuqi te reja per vepra te mdhaja qe jane mbrrijte deri tash. Me kalimin ne ndertimin e socjalizmit, eksperiencat e PK (b) te BRSS, te perpunueme theorikisht me veprat e Stalinit do t'apin mundesi qe kuadrat t'ona te pregaditen theorikisht per kryemjen e drejte te te gjitha atyne detyrave, te cilat per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one, i ka shtrue Kongresi i Peste i PKJ. Kurrefare veshtiresinash, nga çdo ane qe te vijne, nuk do te muejne me na ndo nga rruga e ndertimit te socjalizmit dhe nga lufta kundra imperjalizmit, e ne ket rruge pa tjeter do t'a kemi gjithmone parasysha eksperiencen kolosale te BRSS te perpunueme me veprat e Stalinit.

Rrnofte udheheqesi i njerzimit perparimtar Josif Visarionoviq Stalin!

Vazhdim i referatit politik i punes s'organizatave te Partis ne Kosmet

Çashtja agrare dhe zgjidhja e saje

(vijon nga faqja e dyte)

Çashtja agrare ne teritorin e kesaj Krahine asht zgjidhe shum here ne te kaluemen — tha shoku Gjoko Pajkoviq — por gjithmone ne dam te katundareve.

Mandej ai vueni ne dukje edhe periudhen gjate okupacjonit, ku gjermanet e italjanet, per me e sigurue pushtetin e tyne e bane ujdine prej me agallar e beglere etj.

»Per ket arsye para Partis s'one shtoi ai, si ne kohen e mbajtjes se Konferences se III te te Partis ,ashtu edhe mbas saje qendronte çashtja e fitimit t'influences ne turmat shqipare me izolimin e njikoheshem te reakcjonit shqiptar si detyre themelore politike n'ate kohe. Kryemja e asaj detyre ka qene lehtesue me faktin se Partija e jone, neper luften revolucjonare, si perpara ashtu edhe gjate luftes, tue u-çue ne mprojtje te turmave shqiptare, interesat e te cilave ia rrezikonte borgjezija e mbrendeshme dhe e jashtme, e ka pase linjen e caktueme dhe te kjarte persa u perket shqiptareve«.

Mbassi paraqiti luften per lirine e barazin e pakicave shqiptare ne Kosove, Metohi e Sanxhak dhe luften kundra metodave kolonizatore te borgjezis serbe n'ato krahina, ne ket drejtim organizata e Partis ne Krahinen t'on ka zhvillue disa aksione te randesishme politike, ai shtoi:

»N'ate kohe ka qene e kjarte se Partija e jone dhe levizja Nacjonal-çlirimtare muejten me e fitue besimin e turmave shqiptare, muejten me i zhduke dyshimet qe egzistojshin ke ato ndaj levizjes Nacjonal-çlirimtare, aq ma shum e ma pare, sa ma shum e ma pare t'u ndihmoje atyne qe te çlirohen nga mbeturinat e zgjedhes feudale, aq ma shpejte qe te korigjohen gabimet e randa te politikes kolonizatore, si dhe te sigurohen te drejtat nacjonale.

Organizata e jone ia hyeni zgjidhjes se çashtjes agrare ne baze te direktivave te KQ te PKJ, te cilat ma vone, me ligjin mbi revizjonin e reformes agrare dhe kolonizimin per Maqedonin dhe Krahinen t'one, u-vertetuen plotesisht. Vija themelore ne zgjidhjen e kesaj çashtjeje ka qene: likuidimi i mbeturinave feudale e gjysem-feudale ne baze te njoftjes se pronesis se bujqeve mbi token, te cilet e kane punue. Me kete gja diso mijo bujqesh t'udhehequn nga Partija e jone, e realizuem andren e vet shekullore qe toka te cilen e punojne ata te bahet prona e tyne«.

Mbassi permendi se me vendimet e keshillave popullore u asht hjeke e drejta e pronesis mbi token te gjithe atyne personave qe nuk kane qene bujqe etj., ai tha:

»Me ket rruge, nji numrit te madh familjesh, te cilat pershkak te terrorit te pushtetit t'atehershem jane detyrue me e braktise vatren e tyne, me u-shperngule e emigrue, si dhe atyne qe u ishte marre toka me leqitacjon e masat e tjera te ndryshme terroriste, i u asht kthye perseri prona e plaçkitun. Posaçerisht asht ba revizjoni i reformes agrare me detyre, qe toka e pronareve private te bujqeve shqiptare, e cila me rastin e zbatimit te kolonizimit asht marre nga ana e pushtetit te vjeter dhe u asht dhane kolonistave, t'u kthehet pronareve te maparshem. Me punen per zgjidhjen e kesaj çashtjeje jane shqyrtue e zgjidhe 6.188 konflikte, e pronareve te perparshem shqiptare u jane kthye 21.079 hektare toke. Njikohesisht me kete, ne baze te ligjit te ri mbi reformen agrare, ajo perfundoi ne likuidimin e pronareve te mdhaj«.

Tue fole per mbeturinat e mdhaja feudale, ai theksoi se perveç randesis se pergjitheshme prona kapitaliste ne katund me gjithe qe ka pase shum pak, na ka sherbye mjaft si baze per krijimin e sektorit shtetnuer ne bujqesi, tue ndikue mjaft ne krijimin e pronave shtetnore etj., ai tha:

»Me zbatimin e revizjonit te reformes agrare u-hap problemi i kolonistave, te cilet n'ate menyre e humben pjeserisht ase plotesisht token qe u ishte dhane ma pare. Ktu nuk ishte fjala mbi kolonistat qe e kishin marre token si sherbtore te regjimit dhe zbatuese te politikes se tij, por mbi turmen e kolonistave, te cilet per shkak e pozites se veshtire ekonomike kishin lejue me u-fute ne planet kriminale te zotnive serbo-mdhaj, te cilet u a kishin ngarkue rolin e veshtire te gjandarit t'unshem. Çashtjen e nevojave te tyne per toke e kemi zgjidhe ase tue iu dhane toke nga fondi kolonist, te krijuem nga toka te cilen e kishin leshue disa kolonista, e kishin humbe te drejten mbi te, ase ishin kolonizue ne Vojvodine.«

Zgjidhja e ketille e çashtjes agrare tek ne — shtoi shoku Pajkoviq — ka qene mase shum e randesishme shoqnore e ekonomike, e cila udha grushte te fuqishme si grupit te pronerave te udale ashtu edhe borgjezise katundare.

»Kjo solli ndryshime te mdhoja ekonomike e politike ne katund. Ato perbaheshin ne likuidimin e mbeturinave dhe te pronave te mdha nga nji, ane krijimin e sektorit shtetnuer ne bujqesi, rritjen e pronave te katundarit te mesem dhe te vorfen nga ana tjeter. Me revizjonimin e reformes agrare u-zhduken shkaqet e grindjeve ne maredhanjet ne mes te shqiptareve nga njena ane dhe te kolonistave nga ana tjeter. Politika agrare me keso rezultatesh, ne kushtet e zhvillimit gjithnji ma te sukseseshem te shtetit t'one dhe te rritjes se prestigjit te tij nderkombtar, ishte ajo lidhja e fuqishme ne mes te Partis s'one dhe te turmave shqiptare, me ndihmen e se ciles filloi kthimi i turmave katundare shqiptare nga vija e aleances me borgjezin e tyne na cjonale drejte bashkpunimit e pjesemarrjes aktive ne levizjen Nacjonal-çlirimtare, e kjo don te thote ne taborrin e fuqive revolucjonare te Vendit t'one, te cilat jane tue e ndertue socjalizmin. Nuk duhet as me e theksue se zgjidhja e ketyne çashtjeve ka qene e lidhun me perballimin e veshtiresive shum te mdhaja«.

Mandej shoku Pajkoviq paraqiti shkaqet kryesore qe ka shkue shum ngadale kthimi i turmave shqiptare, e nder keto mbrapambetjen e turmave shqiptare, pazhvillueshmenija e organizates s'one sidomos nder shqiptaret, puna e pa-drejte e komisjoneve agrare dhe keshillave popullore ne zbatimin e revizjonit te reformes agrare, te cilat veshtiresi e kane pengue besimin e shqiptareve ne pushtetin t'one dhe e ka ne komplikue situaten politiken aqe te veshtire ne Krahine.

Realizim i e drejtave kombtare te shqiptareve

Nderkaq ai paraqiti realizimin e te drejtave kombetare te shqiptareve: »Nuk ka dyshim se zgjidhja e çashtjeve agrare ka qene masa ma e randesishme politike shoqnore, e cila asht zbatue te na ne periudhen e vjetit 1945 dhe 1946. Me ket asht zgjidhe lamshi i çashtjeve shoqnore e politike dhe maredhanjeve kombtare ne katund. Por revolucjoni i yne popullor me fuqin e tij, nuk i ka ndryshue vetem maredhanjet ekonomike, ne dobin e shtresave punuese, por njikohesisht i ka ndryshue edhe maredhanjet ne mes te popujve dhe grupeve kombetare, tue e realizue principin e barabaresis se popujve dhe te zhvillimit te lire kultural te te gjitha grupeve kombetare ne Vendin t'one. Ky asht ai fryti i madh i revolucjonit t'one, qe u ba themel i vllaznimit dhe i bashkimit te popujve t'one. Ket fryt e gezojne ne mase te plote ne Vendin t'one edhe shqiptaret te cilet, te lire te zhvillojne gjithnji ma teper dhe ma furishem jeten e tyne kulturale kombtare dhe marrin pjese gjithnji ma aktivisht ne lufte per ndertimin socjalist ne Vendin t'one.

Kur dihet se shqiptareve, ç'prej ardhjes se tyne ne keto vise, u jane pengue te drejtat kombetare gjate shum shekujve dhe u asht ba i pamundeshem zhvillimi i jetes kulturale, me ndalimin e organizimit te shkollave, t'organizatave kulturale dhe t'institutеve arsimore ne gjuhen amtare, si nga ana e pushtetit okupues turk ne te kaluemen e larget, ashtu edhe nga hegemonistat serbo-mdhaj, te cilet, turmat shqiptare i kane mbajte ne robni dhe i kane nenshtrue per çfarosje, — atehere asht e kjarte se ne Jugosllavin e re, per here te pare ne historin e gjate dhe te veshtire te jetes se vet, shqiptaret ne Kosove e Metohi i kane fitue te drejtat e njeriut dhe lirin e zhvillimit te vet kulural«.

Mbassi vueni ne dukje faktin se okupatoret fashiste gjate luftes kane pase hape nji numer te vogel shkollash per shqiptare, ne menyre qe te pregadiseshin nji numer shqiptaresh qe t'i sherbejshin si mjet per politiken robnuese mbi shqiptaret, e qe kjo nuk don me thane realizimin e te drejtave shqiptare, ai tha:

»Vetem Partija e jone, tue i zbatue besnikisht principet e shkences markxiste ne zgjidhjen e çashtjeve kombtare, i njofti te drejtat kombetare te shqiptareve dhe zbatoi politiken e realizimit te tyne te plote. Qe se si shoku Tito, kah mbarimi i luftes ne vjetin 1945, ne bashkbisedim me perfaqesuesat e shqiptarve nga Krahina e jone, e percaktoi qendrimin e Partis s'one ndaj shqiptarve. Ai tha: »Populli shqiptar duhet t'a dije se çfare Jugosllavije po krijojme na dhe se ky ne komunitet te ri, i cili ka kushtue aq shum gjak, do te jete me te drejta te barabarta, se do t'i japin te gjitha mundesinat qe t'a zhvillojne dhe t'a formoje kulturen e vet, t'i fitoje shkollat e veta, t'a perparoje bujqesin e vet. Populli shqiptar do t'i fitoje ne Juogsllavin e re te gjithe ata qe e bajne popullin popull«.

Politika e ketille e Partis s'one ne lidhje me çashtjen e realizimit te barabarsis se te gjitha kombesinave te Vendit t'one e ka gjete shprehjen e vet te plote me Ligjin Themeltar te Shtetit t'one, ne Kushtetuten e RFPJ. N'artikullin 21 te Kushtetutes thuhet: »Te gjithe qytetaret e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis jane te barabarte dhe kane te drejta te barabarta pa marre parasysh kombesine, racen dhe besimin. Nuk njifen kurrefare privilegjesh, nga lindja pozita, gjendja ekonomike dhe dija profesjonale«. Me ket jane suprimue te gjitha privilegjet te cilat e kane kondicjonue barabarsin dhe njikohesisht asht garantue barabarsija e plote e qytetarve. E ketille ka qene baza politike me te cilen asht zgjidhe çashtja kombetare e shqiptarve te na. Ka qene e kjarte se detyret e organizates se Partis ne kete drejtim perbahen, ne rend te pare ne faktin qe t'u ndihmoje shqiptarve per me i gezue sa ma teper e sa ma plotsisht te drejtat e fitueme kombtare. Kjo ka qene vija e inkuadrimit dhe aktivizimit sa ma te gjane te shqiptarve ne te gjitha çashtjet e punes politike dhe ekonomike, d. m. th. ne jeten shoqnore ne pergjithsi. Ne ket drejtim organizata e jone ka ba pune te madhe organizative dhe edukuese ne turmat shqiptare, e cila ka dhane perfundime te dudshme.

Si organizata themelore, me anen e se ciles Partija e ka zbatue ket pune dhe mberrijte keto suksese, ka qene Komiteti shqiptar. Ky asht organizue me nji here mbas çlirimit si organizate nacjonal-çlirimtare antifashiste, si pjese e Frontit Popullor, i cili ka pase per detyre qe, ne baze te programit te levizjes nacjonal-çlirimtare t'i organizoje dhe t'i inkuadroje turmat shqiptare ne Frontin Popullor. Krijimi i kesaj organizate ka qene prove e dukshme e barazis kombetare dhe liris se plote qe e gezojne shqiptaret ne shtetin e ri. Sot mund te themi se detyra themelore, te cilen Partija ia ka pase caktue Komitetit Shqiptar, asht krye me sukses. Tash ne Frontin Popullor gjindet shumica dermuese e shqiptarve, numur i te cilve asht 227,358, te cilet me anen e ketij marrin pjese aktive ne jeten politike dhe shoqnore bashk me qytetaret e kombesinave te tjera. Pjesmarrja e shqiptarve ne punen e organizatave shoqnore dhe te Frontit asht gjithashtu e madhe. Nga numuri i pergjithshem 57.334 n'organizaten e rinis popullore 27.115 jane shqiptar. N'organizaten e FAG-ut marrin pjese aktive 70.550 gra shqiptare, shka ne krahasim me numrin e pergjithshem asht nji shumice dermuese. N'organizatat sindikale prej 28.903 antarve 17.341 jane shqiptar. Ne menyren perkatse asht shtrue organizimi i punes ne te gjitha keto organizata. Prane çdo udhehеqsija politike t'organizatave ekzistojne seksjonet, komisjonet, aktivat, t'organizueme prej shqiptarve, me detyre qe te punojne me turmat shqiptare. Kesitu e tane puna politike ne mes te shqiptarve asht organizue dhe zhvillohet ne gjuhen shqipe. Kuptohet se, ne lidhje me ket pune, ka edhe leshime, qe jane rezultat i qendrimit shovinist te disa anetarve te Partis dhe udheheqsave, serb e shqiptar, te cilet e nençmojne randesine e vetijave kombtare te shqiptarve. Komiteti i shqiptarve e hje dhe tash qendren e gravitetit te veprimtaris se vet ne sektorin e punes kulturo-arsimore. Kuptohet se sot asht shum ma lehte prandaj dhe ma e rekomandueshme qe, puna n'edukimin kulturo-politik te turmave shqiptare, t'organizohet dhe te zbatohet me anen e organizatave te Komitetit shqiptar. Ne lidhje me ket pune duhet pa tjeter te luftojme ngultazi kundra te gjithe elementave shoviniste, te cilet jane pengese per zbatimin e politikes se ketille te vetme te drejte n'organizimin e punes per edukimin e turmave shqiptare.

Aktivizmi i turmave shqiptare ne jeten politiko-shoqnore, perveç randesis se pergjithshme ka pase edhe randesi te veçanta, e ky ka qene kushti, d. m. th. menyra, ne te cilen shqiptaret i kane realizue dhe gezue te drejtat e veta te fitueme ne Jugosllavin e re. Ket e vertetojne shenimet e poshtme: prej 28 deputetve t'asamblеs se perbashket 13 jane shqiptar. Prej numrit te per gjithshem t'antarve te keshillave popullore ne territorin e Krahines jane shqiptare: ne Keshillin Popullor Krahinuer 58%; ne keshillat popullore te rretheve 60 ne keshillat populore te qyteteve 53% dhe ne keshillat popullore te Vendeve 63%. Gjendja e njejte osht edhe n'udheheqsinat e organizatave politike dhe shoqnore. Keshtu per shembull n'udheheqsin e Frontit Popullor punojne 62% shqiptar, ne keshillat e FAG-ut 58,7% jane shqiptare, n'udheheqsinat e rinis popullore ka 52,7% shqiptar, e ne sindikat nga numri i pergjithshem i kuadrit udheheqes 49% jane shqiptar.

Tue fillue nga fakti se mbrapambetja kulturale e shqiptarve, e shprehun ne perqindjen prej 90% analfabetesh, asht pengese serioze si per pjesemarrjen aktive te shqiptarve ne jeten shoqnore, ashtu edhe per zhvillimin e tyne kultural e politik, organizata e jone e Partis e ka shtrue si çashtje themelore te punes ne mes te shqiptarve punen per ngritjen kulturale te turmave shqiptare, ne rend te pare, ne lufte kundra analfabetizmit. Na e kemi shtrue kete dhe zgjidhe si çashtje politike, tue e dijte se analfabetizmi dhe mbrapambetunija asht pengese per pjesmarrjen e tyne te gjane ne ndertimin socialist ne Vendin t'one, e keshtu edhe anmik i rrezikshem i shtetit t'one te ri. Me gjithe veshtirsinat objektive te kondicjonueme me mungesen e pergjithshme per kah puntoret arsimuer dhe njerzit qe dijne shkrim ne pergjithsi, na ne ket pune kemi korre suksese bukur te mdhaja dhe kemi mberrijte perfundime mjaft te mira. Ne zhvillimin e punes per ngritjen e pergjithshme kulturale te turmave shqiptare, çka e ilustrojne ma se miri shenimet qe vijojne: ç'prej çlirimit e deri tash jane mesue me shkrue e kendue 105.000 shqiptar. Jane hape 88 biblioteka dhe salla leximi per shqiptare, 243 shkolla te reja fillore per shqiptar, nji gjimnaz, shkolla normale dhe 22 gjimnaze t'ulta, e jane organizue pes shoqnija kulturo-artistike shqip. Tue perfitue nga keto sukses na kemi mujt sivjet me ia hy punes per hapjen e tet shkollave t'ulta profesjonale shqiptare dhe per organizimin e shum kurseve profesjonale, ku po pregaditen kuadrat shqiptare per detyre te ndryshme n'ekonomi dhe n'administraten shtetnore.

Tue ia hy punes per organizimin e nji pune kaq te gjane e te gjith'anshme per ngritjen kulturale dhe arsimore te turmave shqiptare, njikohesisht na asht dashte me i zgjidhe pa tjeter edhe çashtjet e mjeteve themelore per ket pune, d. m. th. sigurimin e literatyres ne gjuhen shqipe. Asht dashte t'organizohet dhe te zhvillohet veprimtarija botuese ne gjuhen shqipe, e cila do t'ishte ne gjendje me i plotsue nevojat e punes kaq te gjane dhe interesin politik te turmat shqiptare.

Jeta robnuese e shqiptarve ne te kaluemen shprehet ma se kjarti bash ne faktin se nuk kane pase literatyre ne gjuhen e vet, libra te veta dhe as shtypin ne gjuhen shqipe. Zgjidhjen e kesaj çashtjeje e kemi fillue me organizimin e sipermarrjes botuese shqiptare. Kjo punon ne botimin e literatyres marksiste dhe literatyren tjeter perparim-

(vazhdon ne faqen e katerte)

Vazhdim i referatit politik te shokut Gjoko Pajkoviq

(vijon nga faqja e trete)

tare, te librave per shkollat shqipe etj. Njikohesisht kemi zhvillue me mjaft sukses shtypin ne gjuhen shqipe. Tash ne Krahine botohen 5 gazeta ne gjuhen shqipe dhe nji reviste e permuajshme letrare. Tue e marre parasysh se ketu u fole mbi zhvillimin kulturo-arsimuer te shqiptaret, nga randesija politike e ketaj çashtjeje, duhet me theksue, se ky zhvillim nuk ka shkue ne damin e ngritjes kulturo-arsimore te turmave serbe dhe malazeze, çka do te shifet nga referati tjeter. Kjo don me thane vetem se zhvillimi kulturo-arsimuer i Krahines s'one ne pergjithesi asht nise perpara me hapa te drejta. Kjo vetem e vertefon doktrinen markoiste, te cilen e zbaton me besnikri Partija e jone: se zhvillimi i gjane, kultural i nji vendi asht i mundeshem vetem atehere, ne qofte se ne te asht vendosë se pushteti i popullit punues dhe barasija e plote e popujve dhe e qytetarve.

Realizimi i politikes se barazis se grupeve kombetare ne Krahinen t'one dhe sigurimi i perparimit te tyne te perbashket ne bazen e vllaznimit dhe barabarsis asht konfirmue edhe me sistemin e organizimit te shtetit t'one, ne te cilen Krahina e jone e ka fitue poziten e Krahines Autonome. Qe se si ne Statutin e Krahines Autonome te Kosoves e Metohis, me te cilin rregullohen e mardhaniet reciproke te grupeve kombetare zgjidhet kjo çashtje: n'artikullin 3 te ketij Statuti thuhet: »Te gjitha kombesitë nat ne Krahinen e Kosoves e Metohis jane me te drejta te barabarta. Gjuha serbe dhe shqipe perdoren barabarsisht ne te gjitha sherbimet shtetnore ne Krahinen autonome te Kosoves e Metohis. Procedura neper gjyqe zhvillohet ne gjuhen serbe ase ne gjuhen shqipe«. Prandaj, realizimi i politikes se barabarsis se shqiptareve, perveç tjerash, e shpreha ma se miri fakti se gjuha shqipe perdoret lirisht ne sherbimet publike ne Krahinen t'one. N'organizimin e administrates ne gjuhen shqipe, ne mbare aparatin e pushtetit popullor, u asht sigurue shqiptarve mundesija e plote qe ne jeten e perditeshme dhe me rastin e zgjidhjes se te gjitha çashtjeve t'a perdorin gjuhen amtare.

Pozita autonome e Krahines s'one asht kondicjonue me kushtet e veçanta te zhvillimit historik te ketij vendi dhe me gjithe llojshmenimin kombetare te popullsis qe jeton ne te. Ekzistimi i veçorive te ketilla kerkon menyren e veçante te shtruemjes dhe te zgjidhjes se detyreve te pergjithshme dhe te sigurimit te barabarsis nacionale te grupeve kombetare çka organizimi i tille siguron plotesisht. Dhe mandej, n'organizimin e ketille jane krijue kushtet qe me anen e planeve ekonomike krahinore te shfrytzohen ma mire te gjitha bagetit natyrore te Krahines dhe keshtu te shpejtohet zhvillimi ekonomik, i cili caktohet ne planin e Republikes. Praktikisht organizimi i ketille na jep mundesi qe, me rastin e zbatimit te politikes se pergjithshme te Partis s'one ne bazen e analizes se gjendjes konkrete, tue i konstatue te gjitha veçorit qe ekzistojne prane çdo grupi kombetar veç e veç, si rezultat jashtalles te ndryshme te zhvillimit kombetar, politik dhe kultural, t'a gjejme menyren ma te mire dhe ma te pershtatshme per t'u afrue me keto turma, per organizimin e punes se Partis nder-to, dhe keshtu t'i çelim rruget solide per lokuadrimin e turmave ma te gjana te te gjitha kombesinave ne lufte per ndertimin socjalist te vendit kjo rruge duhet te jete, jeta sa ma e plote kombetare dhe politike e çdo grupi veç e veç nen udheheqjen e Partis s'one e ne themelet e shkences markoiste.

Me dhanjen e te drejtave autonome Krahines s'one, u asht dha ne grusht i rande reakcjonarve serbo-mdhaj e shqiptaro mdhaj, te cilet, per sigurimin e interesave te tyne vehtjake, kane perhape theorina »mbi te drejten ma te madhe«, mbi pa mundesin qe serbet, shqiptaret dhe malazezet te jetojne se bashku, tue i vue interesat e disave mbi interesat e te tjerve. Tash asht gjete dhe asht krijue organizimi i jetes se tyne te perbashket, i cili ruen dhe i mprone te drejtat e tyne dhe i cili i lidhe ndermjet vedi me idealet e mdhaje te ndertimit socialist.

Tue fole mbi punen e organizatave te Partis me zgjidhjen e çashtjes se barabar s kombetare te shqiptarve dhe mbi suksenet qe jane mberrijte ne ket pune, asht fole edhe mbi vehshtirsinat dhe pengesat e shumta qe kane ba qe keto rezultate mos te jane ma te mdhaja. Natyrisht, ne ket drejtim asht ma e randesishme me vue ne dukje se ekzistimi i shovenizmit serbo-mdhaj n'organizaten e Partis ka qene nji nga arsyenat kryesore per ket pune. Shovenizmi asht shprehe ne faktin se nga antaret e Partis, serb e malazez jane nençmue veçorit e shqiptarve, se nuk i asht kushtue kujdesi i duhun organit te jetes politike dhe kulturale te shqiptarve ne gjuhen e tyne amtare. Kjo praktikisht ka dashte me thane me ngadalsue zhvillimin kultural e politik te shqiptarve. Gabimet e ketilla t'organizatave te Partis, u kane sherbye elementave nacjonaliste nga radhet e shqiptaret, te cilet i kane interpretue si qendrim politik i Partis ndaj shqiptarve. N'anen tjeter, veshtirsinat me rastin e kanalizimit te drejte te jetes kulturale te shqiptareve, i shtojne ne punen e tyne elementat nacjonalista ne radhet e shqiptareve, te cilet anojne qe kulturen e klasave te vjetrueme t'a paraqesin dhe t'a naltesojne si kulture kombetare, e qe jeten kulturale te shqiptareve t'a organizojne ndamas nga kultura socjaliste qe po zhvillohet ne Vendin t'one.

Ne lufte kundra shovenizmit n'organizaten t'one ka pase randesi kolosale keshillimi i zgjanë prane KQ te PK te Serbis, i cili e denoje ket çashtje ashper n'organizaten t'one. Puna e jone ne ket vjete e mbas vulen e luftes se vazhdueshme kundra shovenizmit, per te cilin shkak edhe ka dhane pertundime te frytshme.

Athue e gjithe kjo çka thame mbi qendrimin e Partis s'one ndaj shqiptareve nuk flet kjartazi mbi zgjidhjen internacjonaliste markoiste te çashtjes kombetare ne Vendin t'one nen udheheqjen e PKJ dhe KQ te saje me shokun Tito ne krye? Athue gjithshka u tha ne ket pjese te referatit nuk asht realitet i gjalle, veper e Partis s'one, qe ne menyre te pamohueshme dhe te pa p e r k u e l s h m e e pergenjeshtron rezolucjonin e Byros Informative?

Per kete asht e nevojshme shton shoku Pajkoviq, qe te vehem ne dukje te mbetat t'ona kryesore ne pune per organizimin dhe zhvillimin e nivelit kultural e politik te shqiptareve dhe mobilizimin e turmave shqiptare ne lufte per ndertimin socjalist ne Vendin t'one, e keto jane se nder antaret e Partis ka egzistue shovenizmi e konkretisht nder serbe e malazeze, se ende organizata e Partis nuk ka gjithshka duhet dhe asht e mundun per organizimin e instituteve dhe organizatave shqiptare e se ne fushen e ngritjes kulturo-arsimore te turmave shqiptare shprehet aktiviteti i elementave nacjonalist te cilet, nen masken e ruejtjes dhe zhvillimit te fryteve kulturale te turmave shqiptare, perpiqen me e ngjalle kulturen e klasave te vjetrueme me qellim qe te pengohet depertimi i kultures se re socjaliste te popujve te Jugosllavis ne turmat shqiptare.

Puna per konsolidimin dhe forcimin e keshillave popullore

Detyra ma e randesishme qe ka qene parashtrue perpara organizates s'one nga ana e Konferences se III-te Krahinore te Partis dhe Kongresit te I-re te PK te Serbis ka qene çashtja e konsolidimit dhe e ndertimit te matejshem te keshillave popullore.

Mbassi shoku Pajkoviq paraqiti çfaqjen e nevojes se forcimit dhe konsolidimit te keshillave popullore here mbas here, barre e cila i binte ne rend te pare Keshillit Ekzekutiv Krahinuer, ai shtoi:

„Si ka qene orjentimi i jone ne lufte per konsolidimin e keshillave popullore? N'ate kohe, gja qe asht krejte e natyrshme, jemi orjentue ne njerzit e varfen te katundit sepse i kemi konsiderue si mbeshtetjen ma besnike te Partis. Mandej, na kemi luftue per perbamjen e drejte ne pikpamje kombetare te keshillave per me iu pergjegje perbamjes nacjonale te popullsis. Suksesi i organizates ne ket pune mvarej prej faktit se sa sukses do te kete ajo, qe ne luften per konslidimin e keshillave popullore te perfshije turmat sa ma te gjana te popullit punues. Si baze per aktivizimin politik te turmave ne lufte per forcimin dhe ndertimin e keshillave popullore dhe si mjet te fuqishem te luftes kundra anmiqeve nder to, neve na kane sherbye principet demokratike, ne te cilat asht organizue e ne te cilat ka zhvillue punen e tij pushteti i jone popullor. Pergjegjesija e keshilltarve ndaj popullit te vet, te çmuemit botnisht te punes se tyne, ka qene metode e perhershme, te cilen organizata e jone e Partis e ka aplikue ne ndertimin e keshillave popullore. Kjo ka ndikue ne menyre mobilizuese ne turmat dhe e ka ngrijte aktivitetin e tyne ne lufte per nji perbamje ma te mire te keshillave dhe per punen ma te mire t'organeve te pushtetit. Aktivitetin e turmave popullore, organizatat t'ona e kane drejtu kah pastrimi i keshilltarve te ndryshem anmiq e te pa-besueshem nga KP.

Ndersa u paraqit roli i organizates se Partis s'one qe deri ne qershuer te vjetit 1945 te krijohen kushtet per syprimin e pushtetit ushtarak, ku prej atehere te gjitha punet e pushtetit kaluen ne keshillat popullore, ai shtoi:

»Na asht deshte me i marre te gjitha masat qe t'i aftesojme keshillat per punet e udheheqjes se detyrve te rindertimit e te ndertimit. Randesi te madhe kane pase ne ket drejtim zgjedhjet e keshillave popullore te mbajtuna ne krejte Krahinen ne gjysmen e vjetit 1945. Ato kane qe na nxiti me randesi qe te zhvillohet interesimi ne turmat ma te gjana popullore per punen e keshillave popullore. Me anen e ketyne zgjedhjeve na kemi krye reorganizimin e aparatit te keshillave popullore, me syprimimin e keshillave te katundeve dhe te komuneve e me formimin e keshillave popullore te vendeve. Ky ka qene nji hap me randesi ne shtruemjen e drejte organizative te keshillave popullore. Me keto zgjedhje asht permiresue edhe perbamja e tyne. Per keshilltare jane zgjedhe ne pjesen ma te madhe qytetare te mira e te ndershem. Mbas ketyne zgjedhjeve, asht zgjanue gjithashtu edhe Keshilli Popullor Krahinuer. E gjithe kjo ka qene nji hap me randesi ne zhvillimin e keshillave popullore nder ne.»

Mbassi vueni ne dukje se mbas ketyne zgjedhjeve elementat, anmiqe tue pase kuptue randesin e keshillave popullore, jane fute nder to dhe, me punen e padrejte dhe me sjelljet e ndryeshme te pakesojne prestigjin e pushtetit para popullit dhe se gjithnji na asht dashte me e zhvillue luften e vazhdueshme per pastrimin e keshillave popullore, e cila detyre qendron edhe tash e tutje para nesh, shoku Pajkoviq tha:

«Por, duhet te kemi parasyshe se me ashpersimin e luftes se klasave, qe asht rrjedhim i te kryemit me sukses te Planit pesvjeçar, bahet diferencimi gjithnji ma i mprefte ne baze klasash dhe, kjo veçanerisht ne katund dhe se kjo duhet patjeter ne kete ase n'ate menyre me pasqyrue deri ne njifare mase edhe ne keshillat e qytetit. Kjo shprehet veçanerisht te keshillat popullore te vendit. Ka ende çfaqja te qendrimit te lubatshem te disa keshillave e te keshilltareve ne lidhje me luften kunder kulakeve. Per shkaqet e njajta, ndodhe, jo ralle, qe te bahen gabime dhe te zhvillohet nji politike e padrejtje ndaj katundarve te varfen e te mesem ne lidhje me grumbullimin e drithit, te leshit te mishit etj. Prandaj lufta per konsolidimin e pushtetit, lufta per punen e tyne te drejte duhet te jete e perhershme dhe e vazhdueshme, aqe gjate sa edhe lufta politike, te cilen Partija e jone e zhvillon kundra elementave kapitalist.

Vija e luftes s'one per konsolidimin dhe forcimin e kshillave t'ona popullore, gjate krejt kesaj kohe, praktikisht ka dashte me thane me i organizue keshillat prej njerzve ma te mire nga gjiu i popullit, ku shumica duhet te jene shqiptare. Na kemi krye me sukses dhe ket detyre ne ket periudhe. Sot perbamja kombtare e kshilave popullore asht si vijon: nder keshillat popullore te vendit ka 63% shqiptare, kurse ne keshillat e rrethit 60%.

Perbamja e ketille kombetare ka sigurue lidhjen e forte te keshillave popullore me turmat shqiptare. Ne kete menyre keshillat popullore u jane ba ma te aferme turmave shqiptare. Karakteri i tyne demokratik dhe politika e tyne u asht e kjarte. Me kete, politika e barabarsis se shqiptareve ka marre shprehjen reale dhe ajo ka ba qe keshillat popullore sot edhe per shqiptaret jane nji fryt i çmueshem i luftes se tyne per te drejtat e barabarta dhe per sigurimin e jetes ma te mire e ma te lumtun. Po kjo, ende nuk don me thane, se principet e politikes s'one kombetare zbatohen plotesisht ne punen e organeve te pushtetit. Ketu, ne rend te pare asht fjala mbi ndreqjen e ngadalshme te perbamjes kombetare n'aparatin e keshillave popullore dhe t'organizatave ekonomike tue mos i marre shqiptaret ne sherbim, gja qe kondicjonon edhe ngadalsime n'organizimin e punes per perdorimin e administrates ne gjuhen shqipe. Zgjidhja e kesaj çashtjeje asht ne vijim e siper, por per kete osh te nevojshme me pase ma teper kujdes nga ana e organizates se Partise, qe kjo te zgjidhet plotesisht e drejte.

Por, nuk mund te thuhet se jane keto te meta dhe dobsina te vetme te keshillave popullore. Une do te ceki me kete rast ato ma me randesi.

N'aparatin t'one drejtues e ekonomik gjinden puntore te mire ne çdo sektor te luftes per kryemjen e planit, por ato jane ne pjesen ma te madhe gjysem alfabet dhe me nji kulture fillestare. Prandaj ato ma se shumti nuk e njofin sa duhet linjen e Partis ne sektorin e pushtetit, çfrytzojne me veshtiresi eksperiencat, te cilat mund t'i gjejne ne shtyp e ne libra etj. ku te gjitha keto shprehen ne punen mjaft te dobet e te ngadalshme te keshillave t'ona. Rrugen, qe kane marre mbas Kongresit te V te PKJ disa Komitete te rrethit per zgjidhjen e kesaj çashtje, me organizimin e kesaj çashtjes, me organizimin e seminareve dhe te kurseve per aftesimin e keshilltareve, nepunsave dhe te udheheqsave n'ekonomi duhet t'a ndjekin edhe organizatat e tjera te Partis, te cilat deri tash nuk e kane ba kete gja. Perveç kesaj, sikurse qe asht konstatue edhe ne Kongresin e V te PKJ, organizimi i keshillave popullore asht i ngushte, qe te mundet me i krye detyrat e parashtrueme ne planin pesevjeçar. Ky problem nder ne bahet aq ma i kjarte, sepse organizata ekzistuese e aparatit te keshillave popullore asht e ngushte dhe jo e plote si dhe aa numurin ma te nevojshem te nepunsave. Neve perpara riorganizimit t'aparatit te Keshillave popullore, qe asht ne vijim e siper na kane munque gjithsejt 1819 nepunsa. Simbas organizimit te paraqame na duhen 1405 nepunsa te ri vetem per keshillat.

Ne munqese te kuadrave nder ne, per aparatin e keshillave popullore, veçanerisht ne kohen e fundit, shum asht tue u fole. Mirepo, nuk flitet per faktin se ne rendin e pare na mungojne kuadrat shqiptare. Ne pasqyren e nepunsave nder keshillat e vendit dhe n'aparatin ekonomik simbas perbamjes kombetare kemi proven e kjarte ne lidhje me kete. Prej numrit te pergjitheshem te nepunsave jane gjithsejt 44.92% shqiptare. Mendoj se çeshtja e gjetjes dhe aftesimit te kuadrave shqiptare asht pike qendrore ne kete çashtje. Mbas Kongresit te V te PKJ na ia kemi fillue organizimit te shkollavet t'ulta profesionile ne gjuhen shqipe dhe te nji numrit ma te madh kursesh te ndryshme, ne te cilat shqiptaret do te pregaditen per keto dettyra. Menyres se ketille te zgjidhjes se çashtjes se kuadrave duhet edhe ma me seriozitet edhe me nji kujdes ma te madh me iu perveshte Komitetet e rrethit e te vendit. Keshtu, kjo asht tash per tash e vetmja rruge per zgjidhjen e drejtje te kesaj çashtjeje. Asht e drejte kur thami se keshillat t'ona popullore jane te gatshme me luftue per kryemjen e detyrave te planit pesevjeçar.

(vijon ne numrin e ardhshem)

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor — Sipermarrja per shtyp dhe botime „Miladin Popoviq" Prishtine
Pajtimet ne fletoren i prenon Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 10008.